



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
REKTORATI

Nr. 771/4 Prot.

Vlorë më 19.03 2026

VENDIM

Nr. 07, datë 19.03.2026

PËR

**MIRATIMIN E ORGANIZIMIT TË CIKLIT TË PREZANTIMEVE
"MARATONOMAKU UNIVLORA – NJË VENDBANIM, NJË HISTORI"**

Në mbështetje të nenit 40 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 26 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; nenit 15 të Rregullores së Brendshme të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; si dhe në përputhje me strategjinë institucionale të zhvillimit dhe rolin e universitetit si aktor i zhvillimit rajonal, Rektorati në mbledhjen e tij të datës 19.03.2026,

VENDOSI:

1. Miratimin e organizimit të ciklit të prezantimeve "Maratonomaku UniVlora – Një vendbanim, një histori", me sloganin "Zbulojmë Vlorën, rrëfejme identitetin", si një nismë periodike akademike dhe promovuese e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.
2. Realizimin e këtij cikli prezantimesh në formë sesionesh periodike (mujore ose dy-mujore), ku çdo sesion i dedikohet një vendbanimi të caktuar të qarkut të Vlorës, duke trajtuar temat në mënyrë ndërdisiplinore.
3. Përfshirjen e stafit akademik, studentëve dhe përfaqësuesve të komunitetit lokal në organizimin dhe zhvillimin e çdo aktiviteti, nëpërmjet prezantimeve akademike, projekteve studentore dhe dëshmime të komunitetit.
4. Ngarkimin e Administratorit të UV-së, Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmëse Akademike, Drejtorisë së Kërkim-Zhvillimit dhe Marrëdhënieve me të Tretët, si dhe njësisë kryesore të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, për bashkëpunimin, koordinimin dhe realizimin e aktiviteteteve.
5. Ky vendim i përcillet Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmëse Akademike, Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivit për realizimin e njoftimeve përkatëse

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORE

PROF. DR. AURELA SALIAJ

